

VENDIM
NR. 477, datë 16.7.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 21.11.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI
OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BERAT, TË QARKUT TË BERATIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë për Bashkinë Berat dhe heqjen nga lista, që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, të pronës me numër 15, kopshti “Kostandin Leka”, Berat, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të pronës me numër 15, kopshti “Kostandin Leka”, Berat, për sistemimin me mjedise pune të Drejtorisë Arsimore Rajonale Berat.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i ndalohet t’i ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia e Beratit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
14	8501 J-3	12/190	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja Çirim Bashkia Berat	400	400	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	Zene forcefish
15	8502 I-5	7/105	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve "Kostandin Leka" Lagja 13 Shtatori Bashkia Berat	511	595	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
16	8501 H-2,3	11/119	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja Dëshmorët e Kombit Bashkia Berat	650	512	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
17	8502 J-5	27/211	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja 28 Nentori Bashkia Berat	660	489	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
18	8503 K-8, J-6	9/58	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve "Donika Kastrioti" Lagja Kushtrim Bashkia Berat	784	540	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
19	8501 F-3	8/19	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve pa dreke Lagja e Bamkadave Bashkia Berat	400	388	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
20	8504 K-6	16/176	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja Uznove Bashkia Berat	700	650	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	
21	8502 H-4	1/44	Truall Ndertese	Kopeshti i femijeve Lagja Kala Bashkia Berat	375	175	Arsim parashkollor	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Arsimore Berat	

